

Deri te:

KËSHILLI MËSIMOR-SHKENCOR I FAKULTETIT FILOLOGJIK

RAPORT I KOMISIONIT RECENZUES PËR ZGJEDHJE-RIZGJEDHJE TË MËSIMDHËNËSVE NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE-SHKENCORE TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

Në pajtim me nenin 173 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/2018, me Vendim të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filologjik, të Universitetit të Tetovës, nr:18-1646/1 të datës 12.12.2019, e në lidhje me Konkursin për zgjedhjen/rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës, të shpallur në të përditshmet “Koha” “Nova Makedonija” të datës 08.11.2019, si dhe në ëeb-faqen e Universitetit [ëëë.unite.edu.mk](http://eeë.unite.edu.mk), është formuar komision recensues në përbërje:

1. Prof.dr Luljeta Isaku (kryetar) profesor i rregullt në Fakultetin Filologjik të *Universitetit të Tetovës*
2. Prof. dr Ejup Ajdini(anëtar) profesor i rregullt në Fakultetin Filologjik të *Universitetit të Tetovës*
3. Prof.dr Avzi Mustafa (anëtar) profesor i rregullt në Fakultetin Filologjik të *Universitetit “Shën Kirili dhe Metodij” - Shkup*

Në konkursin për mësimdhënës për lëndët: **Metodologjia e punës shkencore I, Metodologjia e punës shkencore II dhe Një autor- Faik Konica**, janë paraqitur dy kandidat, edhe atë:

1. **Dr.sc. Shefqet Zekolli**, mësimdhënës i rregullt në programin studimor Gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës.
2. **Dr.sc. Merita Banjica**, mësimdhënëse në shkollën fillore “Ismail Qemali” – Gostivar.

Komisioni recensues, pasi e kontrollloi materialin e konkursit, titullit të lartpërmendur i paraqet këtë:

R E F E R A T

I. TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Dr. Shefqet Zekolli lindi më 31.12.1955 në Prizren. Shkollimin fillor e kreu në fshatin Bllacë ndërsa shkollën e mesme në Gjimnazin “Zef Lush Marku” në Shkup. Studimet deridiplomike i kreu në vitin 1981 në Fakultetin Filologjik në Universitetin “Kirili dhe Metodij” në Shkup ndërsa në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Zagrebit, në grupin Historia dhe teoria e letërsisë, në vitin 1989 i mbaroi studimet e magjistraturës. Thirrjen Magjistër i shkencave të letërsisë e mori duke e mbrojtur para Komisionit të udhëhequr prej Prof. dr. Josip Kekez, me temë të magjistraturës “Këngët popullore lirike të Drinisë”. Thirrjen shkencore doktor i shkencave filologjike e mori në Fakultetin Filologjik të universitetit të Shkupit “Kirili dhe

Metodij” në vitin 2010 ku e mbrojti disertacionin e doktoraturës me temë: Proza në letërsinë shqipe për fëmijë 1945-2000”. Rreth 32 vjet ka punuar nëpër institucionet arsimore të Kosovës e Maqedonisë. Prej viti 1994 deri në vitin 2002 punoi profesor i Gjuhës dhe letërsisë shqipe në Gjinnazin “Zef Lush Marku” në Shkup. Në shkollën e njëjtë ushtroi detyrën e drejtorit, prej viti 2002 deri në vitin 2008. Prej viti 2008 deri në vitin 2011 e kreu detyrën e Udhëheqësit të Sektorit për arsim e kulturë në Komunën Çair të Shkupit. Paralelisht me punën në shkollë të mesme, prej vitit 1994 është i angazhuar në mbajtjen e mësimit në programin studimor Gjuhë shqipe dhe letërsi në Universitetin Shtetëror të Tetovës Në muajin korrik të vitit 2011 është zgjedhur Bashkëpunëtor shkencor për letërsinë shqipe në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup. Njëkohësisht, në këtë institut, prej vitit 2011 e kryen funksionin e drejtorit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup.

II. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Gjatë viteve akademike të periudhës 2014-2019 në Fakultetin Filologjik, programi studimor Gjuhë dhe letërsi shqipe, Dr. Shefqet Zekolli ka mbajtur ligjërata dhe ushtrime tek lëndët në ciklin e parë të studimeve si: **Metodologjia e punës shkencore I, Metodologjia e punës shkencore II dhe Një autor- Faik Konica,** (në programin studimor: Gjuhë dhe letërsi shqipe), Kulturë dhe civilizim shqiptar (në programin studimor: Gjuhë dhe letërsi gjermane), Folklori arbëresh (në programin studimor: Gjuhë dhe letërsi shqipe), Teori e letërsisë (në programin studimor: Gjuhë dhe letërsi angleze, disperzimet në Shkup).

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin Shtetëror të Tetovës, kandidati Dr. Shefqet Zekolli ka realizuar gjithsej **36.64 pikë** nga veprimtaria mësimore-arsimore.

III. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidati është marrë vazhdimisht me hulumtime shkencore në fushën Filologjisë dhe studimeve letrare. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit përbëhet nga artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare, me pjesëmarrje në tubime shkencore ndërkombëtare dhe pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare. Libra të botuar në fushën eseistikes, poezisë dhe prozës, tregimit të shkurtër, studime në fushën e shkencës së letërsisë. Kjo veprimtari e kandidatit është paraqitur më poshtë.

Dr. Shefqet Zekolli gjatë punës së tij shkencore-hulumtuese ka publikuar disa libra dhe punime shkencore.

Në vitin 2010 e ka botuar librin “Proza në letërsinë shqipe për fëmijë”.

Ky libër në mënyrë komparative i studion problemet të cilat dalin në këtë fushë, në mes të cilave veçojmë:

- a) paraqitja dhe zhvillimi i prozës tregimtare për fëmijë në kontekst të standardeve ballkanike dhe botërore.

b) prezenca dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i prozës shqipe për fëmijë në kontekst të strukturave narrative ballkanike e botërore.

c) interesimi dhe studimi sipas gjinive i prozës shqipe për fëmijë.

Me këta tre kapituj u dha një kontribut i çmuar për studimin e çështjeve lidhur me kategoritë dhe vlerat fundamentale dhe estetike, mënyrën e funksionimit, jetës dhe ekzistencës së letërsisë për fëmijë, paralelisht me letërsinë e përgjithshme.

Hulumtimi i mënyrës si letërsia për fëmijë i përshtatet grupmoshave të njeriut në këtë vepër na mundëson të gjenden qasje metodike adekuate dhe mundësi adekuate për diferencimin e këtyre elementeve të rëndësishme të cilat letërsisë për fëmijë i japin të drejtën të funksionojë si tip i posaçëm i të shprehurit letrar-artistik në kuadër të letërsisë së përgjithshme.

Me këtë dëshmohet se në mënyrë të detajuar dhe komparative janë studiuar llojet kryesore të prozës (tregimi, novela dhe romani) në letërsinë shqipe për fëmijë në kontekst të letërsisë për fëmijë te popujt tjerë të Ballkanit, posaçërisht të letërsisë maqedone, serbe, kroate dhe sllovene për fëmijë me të cilat letërsia shqipe për fëmijë në të kaluarën ka qenë në kontakt të drejtpërdrejtë. Duke trajtuar këto çështje arrihet deri te përfundime të rëndësishme të cilat janë shumë të dobishme për studimin krahasues të letërsisë për fëmijë si dhe kontribuon për sqarimin e disa faktorëve të cilët ndikojnë dhe të cilët janë të rëndësishëm për sqarimin e çështjeve të cilat iu interesojnë studiuesve të proceseve letrare në përgjithësi.

Libri “Proza në letërsinë shqipe për fëmijë” është e ndarë në disa kapituj:

- *Hyrje*
- *Zhvillimi historik i letërsisë shqipe për fëmijë me theks të veçantë te proza shqipe për fëmijë*
- *Letërsia shqipe për fëmijë në ish Jugosllavi*
- *Klasifikimi i prozës shqipe për fëmijë*
- *Përfaqësimi i letërsisë shqipe për fëmijë nëpër tekste shkollore*
- *Ndikimi i krijimtarisë gojore në prozën shqipe për fëmijë*
- *Temat dhe motivet e prozës shqipe për fëmijë*
- *Vlerat artistike, edukative dhe njohëse të prozës shqipe për fëmijë*
- *Gjuha dhe stili i prozës shqipe për fëmijë*
- *Kritika letrare dhe studimi i prozës shqipe për fëmijë*
- *Përfundim*
- *Konkluzion*
- *Literatura.*

Në vitin 2013 Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup ia botoi librin “Këngët lirike të Drinisë”. Libri është një hulumtim shkencor nga fusha e letërsisë dhe folklorit të një treve të Kosovës, Drinisë. Ky libër i trajton dhe përfshinë motivet e ndryshme atraktive të këngëve lirike të Drinisë, begatinë e tyre përmbajtjesore, shprehjet e bukura lirike por edhe vlera të padiskutueshme artistike

që kanë këto krijime popullore, të cilat kanë një rëndësi të veçantë. Ky libër është i ndarë në disa kapituj:

- Veçoritë socio-gjeografike të Drinisë*
- Hulumtimi, mbledhja dhe studimi i krijimtarisë gojore shqiptare*
- Klasifikimi i këngëve popullore lirike*
- Këngët rituale*
- Këngët e dashurisë (lirika shoqërore, këngët jorituale)*
- Këngët humoristike*
- Përfundim*
- Bibliografia*

Dr. Shefqet Zekolli ka botuar edhe librin “Poezia shqipe për fëmijë - I” në të cilin ai i trajton çështjet të cilat lidhen me paraqitjen e vjershave të para për fëmijë, zhvillimin historik të këtij lloji të krijimtarisë si edhe shumë çështje tjera lidhur me këtë fushë. Edhe ky libër është i ndarë në disa kapituj:

- *Hyrje*
- *Pasqyrë e shkurtë e zhvillimit historik të poezisë shqipe për fëmijë*
- *Këngët popullore për fëmijë*
- *Fillimet e poezisë shqipe për fëmijë*
- *Poezia didaktike për fëmijë e shekullit XVI*
- *Poezia shqipe për fëmijë e Rilindjes Kombëtare*
- *Poezia shqipe për fëmijë gjatë pavarësisë deri te Lufta e Parë Botërore*
- *Përfundim*
- *Bibliografia.*

Kandidati ka publikuar disa punime shkencore:

- „Letërsia shqipe për fëmijë dhe ndikimi i saj në zhvillimin e tyre të drejtë”, publikuar në revistën shkencore të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, “Studime albanologjike” numër 7, faqe 35-39;

- „Këngët e kapuçave në Drini“ publikuar në revistën për shkencë, kulturë dhe shoqëri „Jehona“ në vitin 2010, faqe 55-63;

- „Poezia shqipe për fëmijë me karakter didaktik-moralizues “ publikuar në revistën shkencore të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve “Studime albanologjike”, nr. 9;

- „Mbrojtja e trashëgimisë kulturore të Shqiptarëve në Maqedoni “, publikuar në revistën shkencore të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve “Scupi”. Punimi është prezantuar në Konferencën shkencore më temë “Mbrojtja e

trashëgimisë kulturore në Maqedoni” e mbajtur më 21.09.2011 në Shkup;

- „Trashëgimia kulturore dhe turizmi në Maqedoni”, publikuar revistën shkencore të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoni “Scupi”. Punimi është prezantuar në Tribunën shkencore “Trashëgimia kulturore dhe turizmi”, mbajtur në Strugë prej 23-24 qershor 2012;

- „Vlerat edukative të letërsisë shqipe për fëmijë”, publikuar në revistën shkencore të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve “Scupi”. Punimi është prezantuar në Tribunën shkencore “Letërsia shqipe dhe shkolla”, mbajtur më 12.12.2013 në Shkup;

- „Rëndësia historike e Kongresit të Manastirit”. Punimi është prezantua në Konferencën shkencore me temë “105 vjetori i alfabetit shqip” të mbajtur më 22 nëntor 2013 në Manastir ndërsa e organizuar prej Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, në bashkëpunim me Institucionin nacional - Muzeu i alfabetit shqiptar;

- „Rëndësia e Ali Ulqinakut për zhvillimin e alfabetit të gjuhës shqipe”. Ky punim është prezantuar në Konferencën shkencore kushtuar personalitetit dhe veprës së rilindësit Hafiz Ali Ulqinaku (1853-1913), organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në bashkëpunim me Institucionin nacional- Muzeu i alfabetit Shqiptar, në prill të viti 2013 në Manastir.

- „Tekstet e para në gjuhen shqipe dhe kontributi i Sami Frashrit për botimin e tyre”.

Ky punim u prezantua në Konferencën shkencore kushtuar personalitetit dhe rolit të Sami Frashrit si ideolog i Rilindjes kombëtare, organizuar në qershor të këtij viti në Manastir nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në bashkëpunim me Institucionin nacional - Muzeu i alfabetit shqiptar me seli në këtë qytet.

-Gjithashtu, kandidati, nga ana e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve është emëruar udhëheqës i studimeve postdiplomike, të cilat tani shpejt duhet të fillojnë.

-Dr. Shefqet Zekolli ishte udhëheqës i Këshillit organizativ Konferencës shkencore me karakter ndërkombëtar me temë “Veprimtaria patriotike e Hasan Prishtinës” e cila u mbajt në Shkup më 13 dhe 14 tetor 2012, me rastin e 100-vjetorit të flamurit dhe shtetit shqiptar.

-Ishte anëtar i Këshillit organizativ i konferencës së mbajtur në vitin 2012 në Shkup, organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve me temë “Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe - vepër me rëndësi të madhe shkencore”. Në këtë konferencë kandidati mbajti një fjalim për rëndësinë e këtij kongresi dhe rëndësinë e vendimeve të cilat u morën aty.

-Ka qenë udhëheqës i projektit “Vlerat e trashëgimisë kulturore të shqiptarëve dhe identiteti kombëtar”, i realizuar më 17 prill 2013 dhe maj 2014 nga ana e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve. Ky projekt u financua nga

Ministria e kulturës ndërsa ka për qëllim të promovojë trashëgiminë kulturore të popullata e të rinjve.

-Ka qenë udhëheqës i Këshillit për organizimin e konferencës shkencore “Kryengritja e shtatorit” e cila u organizua më 4 dhe 5 tetor 2013 në Ohër dhe Dibër. Koorganizator të kësaj konference ishin Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve dhe Instituti i historisë nacionale.

-Ka qenë koordinator i Këshillit për organizimin e Konferencës shkencore me rastin e 100 vjetorit të shtetit shqiptar, organizuar në Prishtinë nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës dhe Instituti i historisë në Prishtinë.

IV. VEPRIMTARIA ARSIMORE

Paralelisht me detyrat e punës si bashkëpunëtor shkencor në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, Dr. Shefqet Zekolli, në ciklin e parë të studimeve në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në Fakultetin Filologjik - në programin studimor gjuhë dhe letërsi shqipe, i ligjëron këto lëndë:

1. Kritika letrare;
2. Folklori arbëresh;
3. Kultura dhe qytetërimi shqiptar.
4. Metodologjia e punës shkencore I dhe II

Gjithashtu, në Fakultetin Filologjik të Universitetit Shtetëror të Tetovës, në ciklin e dytë të studimeve, Dr. Shefqet Zekolli i ligjëron lëndët:

1. Teoritë bashkëkohore letrare dhe
2. Mitologjia shqiptare

Gjatë punës dhe veprimtarisë së tij arsimore në universitet, Dr. Shefqet Zekolli ka qenë mentor dhe anëtar i disa komisioneve për mbrojtjen e shumë punimeve të diplomës.

V. VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE

Dr. Shefqet Zekolli është kuadër i dëshmuar në fushën e hulumtimeve shkencore por edhe në fushën arsimit. Duke pasur parasysh faktin se shumë vite ka qenë profesor në Gjinnazin “Zef Lush Marku” ndërsa gjashtë vjet edhe drejtor në të, aftësitë e tij prej eksperti e menaxheri të mirë janë marrë parasysh në shumë raste:

-Ka qenë anëtar i Grupit nacional të ekspertëve për hartimin e Programit nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005-2015. Ky grup ishte i formuar prej Ministrisë së arsimit dhe shkencës të Republikës së Maqedonisë;

-Në dy mandate ka qenë anëtar i Komisionit për ndarjen e Çmimit “13 Nëntori”;

-Në dy mandate ka qenë anëtar i Komisionit për ndarjen e Çmimit “23 Tetori”;

- Në dy mandate ka qenë anëtar i Komisionit për ndarje e Çmimit “Kliment Ohridski”;

- Gjatë viteve të shkuara ka realizuar qëndrime studimore në disa shtete të rajonit;

- Gjatë vitit 2014 ka realizuar një qëndrim studimor në SHBA, në kuadër të bashkëpunimit me Institutin e Historisë Kombëtare dhe me ndërmjetësimin e Ambasadës së SHBA dhe Ambasadës së Gjermanisë, ku janë vizituar edhe shumë institucione të larta të administratës, shkencës, kulturës e arsimit në Vashington, Boston e Atlanta. Kandidati në fjalë bashkë me fletë aplikimin ka dorëzuar edhe: Vendimin e zgjedhjes PROFESOR INORDINAR; Diplomën e Studimeve deridiplomike; Diplomën e Magistraturës; Diplomën e Doktoraturës, Certifikatën e notave për studimet deridiplomike; Certifikatën e notave të studimeve të ciklit të dytë; Certifikatën e notave të Studimeve të ciklit të tretë; CV akademike; Listën e punimeve shkencore të botuara së bashku me kopje të ballinave të revistave dhe faqeve të punimeve;Kopje të certifikatave nga pjesëmarrja në Konferenca Ndërkombëtare; Kopje origjinale të punimit të Doktoraturës; certifikatën e Në nshetësisë dhe certifikatë lindjeje, Vërtetim për Marrëdhënie të rregullt pune. Librat e botuar.

2. TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Dr. Merita Banjica u lind 01.05.1963 në Banjicë të Gostivarit. Ka diplomuar në vitin 1986 në AP “Kliment Ohridski”-Shkup. Arsimin sipëror e ka kryer në vitin 2006 në USHT, në Fakultetin e Shkencave humane dhe arteve. Në vitin 2010 ka magjistruar në UEJL në Fakultetin e Gjuhëve, kulturave dhe komunikimit. Në vitin 2017 ka doktoruar në UEJL, në Fakultetin e Gjuhëve, kulturave dhe komunikimit dhe morri gradën shkencore Doktor i shkencave të filologjisë.

Ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore. Ka të botuara disa punime në revista të fushës së gjuhës dhe letërsisë. Ka botuar dy libra, një të fushës së lingistikës dhe tjetri në fushën e menaxhimit të arsimit fillor.

PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Në bazë të pasqyrës të prezantuar më lartësi dhe nga të dhënat në **Shtojcë**, komisioni Recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-aplikative dhe veprimtarinë me interes më të gjerë dhe konstaton se kandidati Dr.sc. Shefqet Zekolli në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), ka tubuar gjithsej **332.64 pikë** nga referencat profesionale dhe me këtë e ka kaluar numrin minimal të pikëve që duhet të realizohen për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore **PROFESOR ORDINAR**

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme për aktivitetin e përgjithshëm të kandidatit, Komisioni përfundon se Dr.sc. Shefqet Zekolli ka kualitet shkencor dhe profesional dhe sipas Ligjit për arsim të lartë si dhe në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës i plotëson të gjitha kushtet që të zgjidhet në thirrjen që ka konkurruar.

Komisioni Recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës që kandidati Dr.sc. Shefqet Zekolli të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore **ORDINAR** për lëndët: **Metodologjia e punës shkencore I, Metodologjia e punës shkencore II dhe Një autor- Faik Konica**, programi studimor Gjuhë dhe letërsi shqipe (Fakulteti Filologjik).

ANËTARËT E KOMISIONIT RECENSUES:

- 1. Prof. Dr. Luljeta Isaku(kryetar)**
- 2. Prof. Dr. Ejup Ajdini, (anëtar)**
- 3. Prof.Dr. Avzi Mustafa, (anëtar)**

S H T O J C Ë

PËR RECENSIONIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati:Dr. Shefqet Zekolli

Institucioni: Fakulteti Filologjik-UT, Tetovë

Lëmia shkencore:LETËRSI

I. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
I.1	Mbajtja e ligjëratave (lëndët në ciklin e parë të studimeve)	24
	Metodologjia e punës shkencore 1, (Fakulteti Filologjik-Gj. shqipe) 1 semestër 2+1	$2 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 2,4$
	Metodologjia e punës shkencore II, (Fakulteti Filologjik-Gj. shqipe) 1 semestër 2+1	$2 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 2,4$
	Një autor-Faik Konica, (Fakulteti Filologjik-Gj. shqipe) 1 semestër 2+1	$2 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 2,4$
	Teori e letërsisë I, (Fakulteti Filologjik-Gj. Angleze - Shkup) 1 semestër 2+1	$2 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 2,4$
	Teori e letërsisë II, (Fakulteti Filologjik-Gj. Angleze - Shkup) 1 semestër 2+1	$2 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 2,4$
	Kritike letrare , (Fakulteti Filologjik-Gj. shqipe) 1 semestër 2+1	$2 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 2,4$
	Folklor arbëresh , (Fakulteti Filologjik-Gj. shqipe) 1 semestër 2+1	$2 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 2,4$
	Praktikumi i gjuhës shqipe, (Fakulteti Filologjik-Gj. maqedonase) 1 semestër 2+1	$2 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 2,4$
	Teori e letërsisë, (Fakulteti Filologjik-Gj. Angleze - Shkup) 1 semestër 1+1	$2 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 2,4$
	Kulturë dhe civilizim shqiptar, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 1 semestër 2+1	$2 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 2,4$
	I.2	Mbajtja e ushtrimeve (lëndët në ciklin e parë të studimeve)
Metodologjia e punës shkencore 1, (Fakulteti Filologjik-Gj. shqipe) 1 semestër 2+1		$2 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 1,8$
Metodologjia e punës shkencore II, (Fakulteti Filologjik-Gj. shqipe) 1 semestër 2+1		$2 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 1,8$
Një autor-Faik Konica, (Fakulteti Filologjik-Gj. shqipe) 1 semestër 2+1		$1 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 0,9$
Teori e letërsisë I, (Fakulteti Filologjik-Gj. Angleze - Shkup) 1 semestër 2+1		$1 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 0,9$
Teori e letërsisë II, (Fakulteti Filologjik-Gj. Angleze - Shkup) 1 semestër 2+1		$1 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 0,9$
Kritike letrare , (Fakulteti Filologjik-Gj. shqipe) 1 semestër 2+1		$1 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 0,9$
Konsultime me studentë		5.44

I.3	Folklor arbëresh , (Fakulteti Filologjik-Gj. shqipe) 1 semestër 2+1	80×4×0.002= 0,64
	Praktikumi i gjuhës shqipe, (Fakulteti Filologjik-Gj. maqedonase) 1 semestër 2+1	80×4×0.002= 0,64
	Folklor arbëresh , (Fakulteti Filologjik-Gj. shqipe) 1 semestër 2+1	80×4×0.002= 0,64
	Praktikumi i gjuhës shqipe, (Fakulteti Filologjik-Gj. maqedonase) 1 semestër 2+1	80×4×0.002= 0,64
	Folklor arbëresh , (Fakulteti Filologjik-Gj. shqipe) 1 semestër 2+1	80×4×0.002= 0,64
	Praktikumi i gjuhës shqipe, (Fakulteti Filologjik-Gj. maqedonase) 1 semestër 2+1	80×4×0.002= 0,64
	Folklor arbëresh , (Fakulteti Filologjik-Gj. shqipe) 1 semestër 2+1	80×4×0.002= 0,64
	Praktikumi i gjuhës shqipe, (Fakulteti Filologjik-Gj. maqedonase) 1 semestër 2+1	80×4×0.002= 0,64
	Teori e letërsisë, (Fakulteti Filologjik-Gj. angleze) 1 semestër 1+1	20×4×0.002= 0,16
	Kulturë dhe civilizim shqiptar, (Fakulteti Filologjik-Gj. angleze) 1 semestër 2+1	20×4×0.002= 0,16
Gjithsej (I.1-I-3):		36.64

VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr. Rend or	Emri i aktivitetit:	Pikët
II.1	Tezë doktorate e mbrojtur: “Proza në letërsinë shqipe për fëmijë”	8
	Tezë masteri e mbrojtur: “Këngët popullore lirike të Podrimes”	4
II.2	Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në përmbledhjen e punimeve të konferencës shkencore me bord redaktues ndërkombëtar	36
	1. LETËRSIA SHQIPE PËR FËMIJË DHE NDIKIMI I SAJ NË ZHVILLIMIN E TYRE TË DREJTË, Studime albanologjike, nr.7, faqe 35- 39	3
	2. KËNGËT E KAPUÇAVE NË DRINI, revista shkencore, “Jehona”, f. 55, 2010	3
	3. POEZIA PËR FËMIJË ME KARAKTER DIDAKTIK - MORALIZUESE”, “Studime albanologjike” nr. 9	3
	4. “MBROJTJA E TRASHËGIMISË KULTURORE TË SHQIPTARËVE NË MAQEDONISE” “Scupi”, 2011	3
	5. “TRASHËGIMIA KULTURORE DHE TURIZMI NË MAQEDONISE”, “Scupi”, 2012	3
	6. VLERAT EDUKATIVE TË LETËRSISË SHQIPE PËR FËMIJË- “Scupi”, 2013	3
	7. RËNDËSIA HISTORIKE E KONGRESIT TË MANASTIRIT, Institucioni, Kongresi i alfabetit, Manastir, 2013	3
8. RËNDËSIA E ALI ULQINAKUT PËR ZHVILLIMIN E ALFABETIT TË GJUHËS SHQIPE, Institucioni Kongresi i alfabetit, Manastir 2013	3	

	9. JOSIF BAGERI POETI I PARË SHQIPTAR PËR FËMIJË NË MAQEDONI, “Jehona”, 2014	3
	10. TEKSTET E PARA NË GJUHËN SHQIPE DHE KONTRIBUTI I SAMI FRASHËRIT PËR BOTIMIN E TYRE, Institucioni nacional Kongresi i alfabetit, Manastir 2013	3
	11. KRYENGRITJA E SHTATORIT NË OHËR DHE DIBËR E VITIT 1913, Ohër, Dibër, 2013	3
	12. LUIGJ GURAKUQI, ATDHETAR I DEVOTSHËM DHE KRIJUES PËR FËMIJË, Institucioni nacional Kongresi i alfabetit, Manastir 2015	3
	Pjesëmarrje në takime shkencore me kumtesë	24
II.3	1. LETËRSIA SHQIPE PËR FËMIJË DHE NDIKIMI I SAJ NË ZHVILLIMIN E TYRE TË DREJTË, Studime albanologjike, nr7 faqe 35- 39	3
	2. VLERAT E TRASHIGIMISË OSMANE, ME THEKS TË VEÇANTË NË SHKUP, Stamboll, 2010	3
	3. KËNGËT E KAPUÇAVE NË DRINI, revista shkencore ,“Jehona”,. f. 55, 2010	3
	4. POEZIA PËR FËMIJË ME KARAKTER DIDAKTIK - MORALIZUESE”, “Studime albanologjike” nr. 9	3
	5. “MBROJTJA E TRASHËGIMISË KULTURORE TË SHQIPTARËVE NË MAQEDONISE” “Scupi”, 2011	3
	6. “TRASHËGIMIA KULTURORE DHE TURIZMI NË MAQEDONISE”, “Scupi”, 2012	3
	7. VLERAT EDUKATIVE TË LETËRSISË SHQIPE PËR FËMIJË-““Scupi”, 2013	3
	8. RËNDËSIA HISTORIKE E KONGRESIT TË MANASTIRIT, Manastir, 2013	3
II.4	Monografi të botuara	100
	1. PROZA NË LETËRSINË SHQIPE PËR FËMIJË, Focus, Shkup, 2010	10
	2. KËNGËT LIRIKE TË DRINISË, ITSHKSH, Shkup, 2013	10
	3. POEZIA SHQIPE PËR FËMIJË DHE TË RINJ, Furkan, Shkup, 2015	10
	4. TRASHËGIMIA KULTURORE E PATISHKA REKËS, Furkan Shkup, 2016	10
	5. FJALË PAS FJALE, Furkan, Shkup, 2017	10
II	Gjithsej (II.1-II-3):	208.64

II. VEPRIMTARI PROFESIONALE-APLIKATIVE

Nr.	Emri i aktivitetit:	
------------	----------------------------	--

rendor		
III.1	Anëtar i komisionit universitar	6
	Anëtar i komisionit për transfere në programin studimor: Gjuhë dhe letërsi shqipe	2
	Anëtar i komisionit për vlerësim ose mbrojtje të punimit të diplomës	2
	Anëtar i komisionit për rangim të studentëve të rinj	2
III.2	Udhëheqës	6
	Drejtori i Gjinnazit “Zef Lush Marku” Shkup	2
	Udhëheqës i Sektorit për arsim dhe kulturë në Komunën e Çairit - Shkup	2
	Drejtor, <i>ITSHKSH</i> , Shkup	2
III.3	Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit	12
	Ditët e hapura, USHT 2008/09/10/11/12/13/14/15/16	9
	Promovim i Fakultetit Filologjik nëpër shkolla të mesme 2017/18/19	3

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE	Pikët
VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE	36.64
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	208.64
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE	24
Gjithsej	332.64

ANËTARËT E KOMISIONIT RECENSUES:

- 1. Prof. Dr. Luljeta ISAKU, (kryetar)**

- 2. Prof. Dr. Ejup Ajdini, (anëtar)**

- 3. Prof. Dr. Avzi Mustafa (anëtar)**
